



1. Prezantimi i projekt idesë

1.1 Hyrje

Shqipëria po tërheq gjithmonë e më tepër vëmendjen e turistëve Europianë dhe jo vetëm. Rritja progresive e numrit të tyre përgjatë viteve të fundit është një tregues i qartë se natyra, pozicioni gjeografik, kombinimi i relievit malor me atë detar apo edhe ushqimi i ofruar janë aspekte që ofrojnë një eksperiencë ndryshe për ata që synojnë të eksplorojnë vendin tonë. Në vazhdim, frekuenca e lartë e artikujve dhe produksioneve televizive nga mediat e huaja për turizmin Shqiptar është një tjetër tregues i këtij interesi në rritje nga ana e vizitorëve të huaj.

Duke parë potencialin që kjo industri ofron për zhvillimin e vendit si nga ana ekonomike ashtu dhe ato socio-kulturore e promovuese të vendit, turizmi është rrjedhimisht edhe në fokusin e politikave dhe strategjive qeveritare. Në kuadër të rugëtimit të Shqipërisë drejt aspiratave Evropiane dhe ato të Bashkimit Europian, turizmi është një mekanizëm që lehtëson në nivele të shumëfishta hapjen por edhe adaptimin e vendit tonë drejt këtyre vlerave e standarteve.

Është me vend të theksohet se sektori i shërbimeve të turizmit ka ecur drejt përmirësimit. Komponentë të strukturimit të guidave turistike dhe shpërndarjes së informacionit kanë pësuar ndryshime të dukshme pozitive. Arteria kryesore dhe hapësira më e madhe e turizmit Shqiptar ende mbetet bregdeti Jonian dhe Adriatik. Kjo si nga ana e potencialit që ofron por edhe sfidat që vijnë bashkërisht me rritjen e numrit të turistëve dhe kërkesat për një diversifikim të shërbimeve të ofruara. Për më tepër, fokusimi i përpjekjeve dhe burimeve në këto zona pa dyshim që mund të sjellë përfitime më imediate dhe të dukshme krahasuar me territore të tjera. Kjo si për të inkurajuar mënyra më fitimprurëse nga ana e punësimit sezonal ashtu edhe më koherente në aspekte të mbrojtjes së ambjentit dhe ofrimit të një turizmi bashkëkohor.

1.2 Cfare kërkojmë të bëjmë?

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm të institucioneve shtetërore, shoqërinë civile dhe sektorin privat synon të ofrojë një risi drejt eksplorimit të mundësive për të mbështetur turizmin shqiptar përmes angazhimit të të rinjve. Kjo duke përqafuar një përjasje inovative të trasmetimit të informacionit, mikpritjes së turistëve, si edhe punësimit të të rinjve në periudhën e verës, ndërkohë që njëkohësisht do të inkorporojë një model ekologjik dhe komunitar nëpërmjet edhe ndërgjegjësimit mjedisor.

Në formulimin e këtij projekti propozimi janë marrë në konsideratë:

- eksperiencat e ngjashme nga vende të tjera;
- nevoja për rritjen e cilësisë së shërbimit informues për turizmin' dhe
- kapacitetet ekzistuese të institucioneve të formimit profesionale në vend.

Në periudhën dy mujore, 1 Korrik – 31 Gusht, në të gjithë vendin do të zhvillohet dhe zbatohet një fushatë me angazhimin e një numri vullnetarësh, studentësh dhe nxënësish të shkollave

profesionale (mbi 18 vjeç), nën drejtimin e strukturave rajonale të Ministrise (Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura në çdo qark), në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, për të shpërndarë informacionet e nevojshme dhe sqaruar turistët vendas dhe të huaj.

Projekti do të krijojë një brand të ri dhe do të prodhojë një seri materialesh promovuese e informuese që do të përdoren për këtë fushë.

1.3 Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i projektit është informimi dhe mikpritje e turistëve gjatë qëndrimit të tyre në vendin tonë. Sigurisht që fokusi do të jetë për turistët e huaj por edhe ato vendas do të jenë pjesë e informimit për aktivitetet që do të zhvillohen në periudhën e pushimeve të verës sipas programeve të miratuara dhe në vendet natyrore dhe kulturore që janë pjesë e hartës së atraksioneve turistike. Përveç informimit turistik, aktivitetet që do të angazhohen do të jenë pjesë e një ndërgjegjësimi për mjedisin e plazheve e përreth, zona që përballen me presionin e aktivitetit turistik dhe rritjes së pranisë njerëzore.

Objektivat kryesorë të projekti janë:

- Paraqitja e vendit tonë si një destinacion i qëndrueshëm turistik, një vend pushimi i sigurtë, i pastër dhe mikpritës për turistët vendas dhe të huaj.
- Punësimi i një numri të konsiderueshëm të rinjsh në sektorin e promovimit dhe shërbimeve turistike në Shqipëri.

Projekti gjithashtu mbështetet në një sërë objektivash specifik që janë:

- Të ofrojë një hapësirë dhe platformë që të rinjtë Shqiptarë të përfshihen në aktivitete për të dhënë jetë një anagazhimi të konsiderueshëm të tyre në fushën e mjedisit dhe turizmit në Shqipëri;
- Të ndërtojë një model punësimi dhe përfitimi njohurish praktike për ta në drejtim të ofrimit të një mbështetje komunitare dhe mjedisore në funksion të ndërtimit të një imazhi dinjitoz të Turizmit Shqiptar;
- Bregdeti shqiptar por edhe qytetet në brëndësi të vendit, të promovohen në një mënyrë tërheqëse dhe të qëndrueshme sa më afër kërkesave dhe standarteve bashkëkohore;
- Krijon një model sa më të mirë bashkëpunimi, bashkërendimit dhe koordinimi, midis strukturave përkatëse të qeverisë qendrore, vendore dhe bizneseve lokale;
- Promovim i të rinjve që janë duke ndjekur apo kanë përfunduar studimet në arsim profesional. Kjo duke i parë ata si asete të dobishëm për zhvillimin dhe vazhdimësinë e infrastrukturës së nevojshme për qëndrueshmërinë e industrisë së turizmit dhe nevojave të tjera komunitare.

1.4 Si do të menaxhohet?

Projekti do të ngrihet struktura të përkohshme për menaxhimin e të gjithë situatës në vend. Për drejtimin e tij do të ketë një Komitet Menaxhimi në qëndër që do të drejtohet nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, me përbërje të Drejtorëve që do të përfshihen në këtë aktivitet si edhe të partnereve në zbatimin e projektit. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura do të shërbejë si Sekretariat për këtë Komitetet.

Për organizimin e punëve në terren do të ngrihen 7 shtabe rajonale (Shkodër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Vlorë, Kukës, Korçë) nën drejtimin e Prefektëve dhe koordinim të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura, dhe pjesmarrje të disa institucioneve lokale. Shtabet rajonale do të mbledhen rregullisht në intervale të shkërtëra kohe për të aprovuar detyrat e punës. Gjithashtu do të jenë të përcaktuara pikat e grumbullimi dhe shpërndarjes, zona mbulimi për grupet e terrenit si edhe organizim ditor përgjatë çdo jave.

Projekti do të ketë një fazë përgatitore një mujore (Maj) ku do të përcaktohen qartë planet e punës përgjatë tre muajve si edhe kush do të bëjë çfarë.

Projekti nëpërmjet shoqatës do të ngrejë edhe disa kampingje me mbështetjen edhe të shoqatës ECOVOLIS ku do të strehohen e argëtohen të rinjtë pjesmarrës.

1.5 Rezultatet e Pritshme të Projektit

Me anë të kësaj përjasje shumë dimensionale, ky projekt synon që me përfshirjen e një numri aktorësh që luajnë një rol në industrinë e turizmit të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- Punësimi, fuqizimi, angazhimi, aftësimi mbi 1.000 të rinjve dhe të rejave në shërbime turistike dhe angazhime mjedisore;
- Promovimi i shërbimeve turistike dhe vlerave natyrore/kulturore përmes 30 pikave informacioni ose qendra vizitorësh të shpërndara në të gjithë vendin, duke përfshirur në të njëjtën kohë një përjasje aktive për mbrojtjen e natyrës dhe fuqizimin e komuniteteve lokale;
- Krijimi i një modeli promovues të turizmit Shqiptar përmes informacionit të drejtpërdrejtë të atraksioneve natyrore-kulturore dhe aktiviteteve me karakter lokale;
- Ngritjen e 8 eko-kampeve rinore që do të ofrojnë mundësinë për të rinj të tjerë por edhe për vizitorë të përkohshëm që të përfshihen në aktivitete vullnetare në dobi të komuniteteve;
- Vendosjen ose rivitalizimi i qendra të informimit (info-points) të cilat do të jenë ndihmuese, informuese, mbështetëse e lehtësuese për mikëpritjen, informimin, drejtimin e vizitorëve;
- Përmes kontakteve me bizneset lokale në rajone të ndryshme të zonës bregdetare dhe qyteteve turistike, të promovohen gjerësisht produktet e tyre ushqimore, shërbimet hoteliere apo edhe të tjera turistike, duke synuar rritjen e përfitimeve ekonomike të sa më shumë bizneseve në zonat përkatëse.
- Prodhimi dhe promovimi i një brandi të ri, portali web dhe materialeve promovuese për një fushatë të gjërë informimi.

1.6 Vendndodhjet

Lista me zona dhe vende ku do të ngrihen qendrat e informimit si edhe kampingjeve, që lidhet me përqëndrimin e punës që do të kryhet në terrenin, jepet më poshtë. Pjesmarrësit në këtë fushatë do të kenë pika fikse të dukshme për dhënie/shpërndarjen e informacionit (info point), që do të shërbejnë edhe si vendet ku çdo mëngjes do të merret plani ditor nga personat e angazhuar dhe gjatë ditës do të ketë grupe lëvizëse me programe të miratuara.

Për zbatimin e planit vendet ku do të ketë strukturat e programit (info point) ose qendra vizitorësh dhe do të mbulohen me prani të aktivistëve do të jenë (hartat ndodhet në *Shtojcën 1*):

Pikat kufitare të hyrjes së turistëve

1. Pika kufitare e Morinës (Kosova)
2. Pika kufitare e Murriqanit (Mali i Zi)
3. Porti i Durrësit
4. Aeroporti i Tiranës
5. Pika kufitare e Qafthanës (Maqedoni)
6. Porti i Vlorës
7. Pika kufitare e Kapshticës (Greqi)
8. Pika kufitare e Kakavijës (Greqi)
9. Porti i Sarandës

Plazhet/qytetet ku ka prezencë të madhe turistësh

1. Plazhi i Velipojës
2. Plazhi i Shëngjinit
3. Gjiri i Durrësit (Ura e Dajlanit)
4. Gjiri i Durrësit (mbikalimi në Plepa)
5. Lungomare e Vlorës (tek Skela)
6. Zona e Rradhimës (qendër vizitorësh)
7. Llogora (qëndër vizitorësh)
8. Plazhi i Dhërmiut (tek kthesa e rrugës kryesore)
9. Porto Palermo
10. Plazhi/qytetit i Himarës e zonat përreth
11. Zona e Ksamilit (tek Parku)
12. Tushemisht

Vënde jashtë zonës bregdetare/malore

1. Qyteti i Shkodrës
2. Parku i Thethit (qëndër vizitorësh)
3. Parku i Valbonës (qëndër vizitorësh)
4. Qyteti i Beratit
5. Sheshi para Bashkisë Durrës
6. Qyteti i Pogradecit
7. Qyteti i Sarandës
8. Qyteti i Përmetit (qëndër vizitorësh)
9. Qytetet i Gjirokastrës (qëndër vizitorësh)

Vendet e kampingut

Për qëndrimin e njerëzve që do të angazhohen në këtë fushatë por edhe për aktivitete të ndryshme do të ngrihen vendqëndrime me tenda pranë pikave ku ofrohen edhe shërbime të tjera (ujë, tualete, sheshe të lira, etc.)

Në zona të tjera

1. Zyrat e ZM në Velipojë
2. Zyrat e ZM në Divjakë
3. Plazhi i Jalë-s